

20151945372

**L I G J**  
**PËR GARANCI TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË TË OBLIGIMEVE SIPAS**  
**MARRËVESHJES PËR HUA PËR FINANCIMIN E AKSIT RRUGOR SH TIP-**  
**RADOVISH, QË DO TË LIDHET NDËRMJET BANKËS EVROPIANE PËR**  
**RINDËRTIM DHE ZHVILLIM DHE NP PËR RRUGË SH TETËRORE**

Neni 1

Republika e Maqedonisë e garanton pagimin e obligimeve dhe përmbushjen e dispozitave të Marrëveshjes për hua për financimin e aksit rrugor Shtip-Radovish, që do të lidhet ndërmjet Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore në shumë prej 64.000.000 euro, nëse Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore nuk i plotëson dhe servison obligimet nga Marrëveshja për hua.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas përcaktohen me Marrëveshje për hua nga neni 1 i këtij ligji, që do të lidhet ndërmjet Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore për financimin e aksit rrugor Shtip-Radovish.

Neni 3

Të gjitha obligimet që dalin nga Marrëveshja për hua nga neni 1 i këtij ligji, si dhe servisimin e huas do t'i kryejë Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore nga të hyrat që i realizon, në afate dhe kushte të përcaktuara në Marrëveshjen për hua nga neni 1 i këtij ligji.

Neni 4

Afati për pagimin e huas nga neni 1 i këtij ligji është 15 vite, me grejs periudhë të përfshirë prej katër vitesh.

Shkalla e kamatës është variabile dhe përbëhet nga EURIBOR gjashtëmujor i ymadhuar për margjinë 1%.

Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore do t'i paguajë Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim provizion të njëhershëm në shumë prej 1% të shumës së huas.

Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore do t'i paguajë Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim provizion në shumë prej 0,5% nga shuma e patërhequr e huas në nivel vjetor.

Neni 5

Për rregullimin e të drejtave dhe obligimeve të ndërsjella që dalin nga Marrëveshja për hua nga neni 1 i këtij ligji dhe Marrëveshja për garanci, Ministria e Financave dhe Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore do të lidhin marrëveshje të veçantë.

Neni 6

Qarkullimi i të mirave dhe shërbimeve i kryer ndaj Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore, të dedikuara për aksin rrugor Shtip-Radovish të financuar me Marrëveshje për hua nga neni 1 i këtij ligji lirohet nga tatimi mbi vlerën e shtuar me të drejtën e heqjes së tatimit paraprak.

Importi i të mirave/shërbimeve nga Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore, të dedikuara për aksin rrugor Shtip-Radovish të financuar me Marrëveshje për hua nga neni 1 i këtij ligji, lirohet nga tatimi mbi vlerën e shtuar dhe detyrime doganore, si dhe nga akciza gjatë importit të automobilave dhe vajrave minerale.

Për qarkullimin e kryer ndaj Ndërmarrjes Publike për për Rrugë Shtetërore, të dedikuara për aksin rrugor Shtip-Radovish të financuar me Marrëveshje për hua nga neni 1 i këtij ligji, për të cilin i njëjti është obligues tatimor sipas neneve 32 pika 4 dhe 32-a të Ligjit për tatim mbi vlerën e shtuar, lirohet nga obligimi për llogaritjen dhe pagesën e tatimit mbi vlerën e shtuar.

Obliguesi tatimor që kryen qarkullim për të cilin është liruar nga tatimi mbi vlerën e shtuar sipas paragrafit (1) të këtij neni, detyrimisht përveç emrit (emërtimit) të pranuesit të së mirës ose shfrytëzuesit të shërbimit, në faturë i shënon edhe emërtimin e projektit edhe emërtimin e Marrëveshjes për hua nga neni 1 i këtij ligji.

Ndërmarrja Publike për për Rrugë Shtetërore gjatë importit të të mirave të liruara sipas paragrafit (2) të këtij neni, organit kompetent doganor detyrimisht i dorëzon kopje të Marrëveshjes për hua nga neni 1 i këtij ligji dhe deklaratë se të mirat/shërbimet e importuara janë të dedikuara për aksin rrugor Shtip-Radovish të financuar me Marrëveshje për hua nga neni 1 i këtij ligji.

#### Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".